



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0534

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Kimete Gashi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE) N.SH.T. “VIKTORY COM”, kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1, me 08/08/2024, mori:

Vendim

- Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE N.SH.T. VIKTORY COM me nr. 2024/0534 , e datës 21/06/2024, kurse vendimi i AK “KOMUNA E GJAKOVËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1.
- Anulohet** njoftimi për anulim e aktivitetit të prokurimit lidhur “Ndërtimi i Rrugës X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1 iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) “KOMUNA E GJAKOVËS” dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
- Në afat prej 5 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarrura lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
- Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 14.04.2023, “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i Rrugës X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1. Ndërsa me datën 03.06.2024 ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 4,357,000.00.

Me 07.06.2024, N.SH.T. “VIKTORY COM” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 12.06.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.06.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.SH.T. “VIKTORY COM” me nr. 0534/2024 për lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i Rrugës X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.SH.T. “VIKTORY COM” janë parashtruar si në vijim:

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është skandaloz dhe diskriminues ndaj kompanisë sonë, ku shkelen parimet kryesore siç janë ekonomiciteti dhe efikasiteti, barazia në trajtim – jo diskriminim, shkelet kodi etik i prokurimit publik dhe vet etika profesionale. Autoriteti Kontraktues, përkatësisht zyra e prokurimit publik, është duke bërë mashtrim me vendimet që po i merr dhe është duke keqpërdorur detyrat zyrtare. Andaj, kërkojmë nga OSHP-ja që të marrë masa ndaj këtyre zyrtarëve, pasi qëllimi i AK-së nuk është të shpërblehet me kontratë ky GOE i shpallur, por të shkojë te OE me çmimin më të lartë.

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, është duke bërë shkelje të ligjeve dhe rregulloreve të cilat janë të parapara për vlerësim dhe dhënie të kontratës. Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, përkatësisht zyra e prokurimit dhe komisioni vlerësues, i cili është vlerësues i tre fazave të ofertës, përkatësisht kryetari i Komisionit, Lekë Sina, është i pazëvendësueshëm në të tre fazat. Si pasojë e kësaj, ky komision dhe zyra e prokurimit po nxjerrin vendim të njëanshëm dhe gjithashtu duke bërë edhe keqpërdorim të detyrës zyrtare, ku po përdorin të gjitha metodat për të na eliminuar dhe duke bërë edhe shpifje ndaj institucioneve të tjera.

Dy vendimet e ngritura nga ky komision dhe zyra e prokurimit janë anuluar nga OSHP-ja, pra ky komision është jo legjitim të bëjë tre vlerësime dhe kjo është antiligjore.

Ne, si GOE Nsht Viktory Com & Eskavatori Company & Marisa sh.p.k., i kundërshtojmë të gjitha pretendimet e Autoritetit Kontraktues si të pabazuara, duke u thirrur në disa pretendime jo eliminuese. Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, përkatësisht nenit 72, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë sqarime shtesë për të plotësuar dhe sqaruar dokumentet të cilat gjenden në ofertë dhe për të plotësuar dokumentet për dëshmitë e paraqitura. Dhe si pas Rregullores nr.001/2022 përkatësisht nenit 38 Sqarimi I Tenderit duhet të kërkojë sqarime shtesë dhe të bashkangjitur gjenin Nenin 38 në faqen 14.

Pretendimi 1. Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar për arsyeje se lista e punëtorëve është në emër të një projekti tjetër. Ne ju sqarojmë se lista është njëjtë për të gjitha projektet dhe nuk ndryshohet sepse i kemi punëtorët e njëjtë gjithashtu si dëshmi plotësuese i kemi të bashkangjitur edhe Listën e ATK-se ku kjo liste është dëshmi se ne kemi këta punëtorë dhe se ne plotësojmë kushtin dhe kriterin e kontratës pra në dosjen e tenderit nuk është kërkuar të paraqitet lista e punëtorëve me emër të projektit dhe si dëshmi po ju dërgojmë edhe njëherë

Dëshmi gjeni Listën e Pagave në ATK ku nr i Punëtorëve është 165.

Pretendimi 2. Se udhëheqësit të punishtes i mungon certifikata për menaxhimin e kantierit ju sqarohet se për shkak të volumit të dokumenteve nuk është ngarkuar i gjithë fili për shkak të megabyteve të file-it dhe si dëshmi po ju përcëllimin Certifikatën për Menaxhimin e Kantierit.

Me poshtë gjeni dëshminë

Pretendimi 3. Autoriteti Kontraktues nuk mund të na eliminojë për arsye jo eliminuese, ku si dëshmi e inxhinierit të elektro është kontrata e tij e dorëzuar në dosjen e tenderit. Në bazë të nenit 72, AK duhet të kërkojë sqarime shtesë për dokumentet dhe dëshmitë që gjenden në ofertë, për të plotësuar dokumentet dhe për ti sqaruar ato. Si dëshmi, po ju dërgojmë kontratën e inxhinierit dhe CV-në.

Dëshmi kontrata dhe CV faqja e pare

Pretendimi 4. Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar me arsyen se Punëtorët e Certifikuar si pas SSHP-se nuk kanë liste, ky pretendim i AK është i pabazuar. Pasi që në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të ketë të certifikuar 50 punëtorë me certifikatat e Siguria dhe Shëndeti në Pune (SSHP-se) ku si dëshmi janë certifikatat e punëtorëve dhe dëshmia tjetër është lista punëtorëve dhe lista e Pagave të ATK-se. Gjithashtu edhe punëtorët e Kompanisë Nsht “Viktory Com” të cilët gjenden në Dosjen e Tenderit janë të certifikuar Siguria dhe shëndeti në Pune dhe si dëshmi do të ju paraqesim.

Pretendimi 5. Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar me arsyen se nuk kemi vlerësimin e rrezikut. Ky pretendim është i pabazuar për arsyen se asnjë punëtor nuk mund të certifikohet për siguri dhe shëndet në punë pa e pasur vlerësimin e rrezikut, dhe vlerësimi i rrezikut gjendet në ofertën tonë. Gjithashtu, e kemi të noterizuar edhe vërtetimin për të cilin dëshmohet se Kompania Eskavatori ka vlerësim të rrezikut dhe është i noterizuar. Ky kriter është i plotësuar nga grupi ynë

Pretendimi 6. Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar me arsyen se Shpresa Haziri, e cila është Lead Auditor sipas ISO 9001-2015, nuk plotëson kriteret. Ky pretendim është i pabazuar për arsyen se Shpresa Haziri në të kaluarën e ka pasur mbiemrin Veseli dhe gjendet në listën e pagave të ATK-së dhe në listën e punëtorëve. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues është i obliguar, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), të kërkojë sqarime shtesë për dokumentet dhe

dëshmitë të cilat gjenden në ofertë, dhe ne si Operator Ekonomik jemi të detyruar ti përgjigjemi kërkesës suaj. Andaj, po ju dërgojmë dëshmitë se punëtorja Shpresa Haziri ka pasur mbiemrin Veseli. Si dëshmi, gjeni aktvendimin e lëshuar nga Komuna e Ferizajt.

Dëshminë e gjeni me poshtë

Te gjitha pretendimet e Autoriteti Kontraktues janë te pa bazuara ku ju dëshmuam te gjitha pretendimet e paraqitura

Sipas Ligjit te Prokurimit Publik dhe RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK konkretisht sipas Nenit 38,Sqarimi i Tenderëve është dashur te kërkohet sqarime shtese për te plotësuar ose sqaruar dokumentet e paraqitura ,pra Autoritet Kontraktues Komuna e Gjakovës nuk e ka respektuar Ligjin e Prokurimit Publik.

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve

38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike.

38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të

përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon/nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE.

Autoriteti Kontraktues duhet ti përmbahet ligjit të prokurimit publik, jemi GOE me çmimi me te ulet ne këtë Aktivitet dhe jemi të përgjegjshëm AK duhet ti trajtoj OE ne mënyrë të barabartë ashtu siç e përcakton Neni 1,6,7 i LPP-se.

Neni 1 , i LPP-se L Qëllimi 1.: “1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6, i LPP-se përcakton:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Neni 7, i LPP-se, përcakton:

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në

të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndaj ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Autoriteti Kontraktues i Komunës së Gjakovës, edhe pas paraqitjes së provave dhe fakteve në Kërkesën për Rishqyrtim, nuk i merr parasysh dhe merr vendim mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim. Pra, siç shihet nga vendimet e AK-së, qëllimi i tij është vetëm anulimi në këtë rast, pasi që nuk arriti të shpërblejë me kontratë Operatorin Ekonomik të favorizuar nga AK-ja. Tani dëshiron anulimin, duke bërë shkelje të rëndë të LPP-së.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër N.SH.T. "VIKTORY COM" konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 38, 56, 59, 60, 69, 72, 108/A të LPP-së si dhe Rregullore Nr.001/2022 për prokurim publik Neni 97 Shkeljet e renda pika D dhe E. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, kërkojmë nga OSHP-ja që të aprovohet kjo Ankesë dhe të anulohet Njoftimi i datës 03.06.2024 për anulimin e tenderit "Ndërtimi i Rrugës X" me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1. Lënda të kthehet në Rivlerësim dhe të zbatohet Vendimi i OSHP-së: OSHP: 2023/0560-OSHP: 2023/0572, i datës 08.12.2023, dhe Vendimi i OSHP: 2024/0100, i datës 29.03.2024, dhe të nënshkruhet kontrata me Grupin e Operatorëve Ekonomik N.SH.T. "VIKTORY COM", Company Eskavatori SH.P.K., Marisa SH.P.K.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.06.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ju si Grupi i Operatorëve ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K. keni prezantuar Listën e punëtorëve nga kompania Eskavatori" është listë e dedikuar për projektin me titull: Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë— Pjese e qarkores se qytetit, me nr. të prokurimit: 632-23-636-5-1-1 dhe si e tillë nuk vlen për këtë aktivitet të Prokurimit, pra kjo listë nuk është siç është kërkuar me FDT dhe OE është administrativisht ipa përgjegjshëm. Referuar edhe vendimit të OSHP me nr. OSIIP. 2023/0560 i dt. 08. 12,2023, faqe 8 ku GOE i rekomanduar për kontratë ishte shpallur i pa përgjegjshëm për shkak të titullit të kontratës për kontratën e kamionëve, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;

Te ky grup i OE, ne baze te dokumenteve të dorëzuara për stafin profesional si Vendimet, CV, diplomat dhe kontratat e punës janë gjetur këtë mangësi:

Pretendimi juaj Udhëheqësit ne punishte ne projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit te rrugëve Besnik Zogu, nuk ka mundur ti ngarkohet certifikata për menaxhim dhe organizim te kantierit për shkak të megabaitve të Fail-it, nuk qëndron sepse ju keni mundur që dokumentacionin ta ndani ne disa fjalë.

Për Inxhinierin e Elektrikes Kriste Duzhmani, nuk ju janë kërkuar sqarime shtesë konform nenit 72 , sepse këtë dokumente nuk munde te vërtetohen nëse ekzistenca e tyre është para datës se dorëzimi te tenderëve dhe nuk munde te verifikohet nëse kane ekzistuar para datës se dorëzimit te ofertave.

Ju keni bashkangjitur 54 certifikata të SSHP (Siguria dhe shëndeti në punë), të Cilat janë për punëtorët e liderit Eskavatori" , mirëpo lista e punëtoreve nga kompania "Eskavatori" është listë e dedikuar për projektin me titull: "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë — Pjese e qarkores Se qytetit", me nr. të prokurimit: 632-23-636-5-1-1 dhe si e tillë nuk vlen për këtë aktivitet të prokurimit, pra kjo listë nuk është siç është kërkuar me FDT dhe OE është administrativisht i pa përgjegjshëm, prandaj edhe pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron, sepse ju jeni eliminuar se lista e punëtorëve nga kompania Eskavatori" është listë e dedikuar për projekt tjetër;

Autoriteti kontraktues në FI)T-ë ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet te ketë vlerësimin e riskut për te gjitha pozitat e punës nga një kompani e licencuar prej MPMS dhe te dëshmohet me raport te noterizuar. Nga lideri Eskavatori" është dorëzuar raporti i vlerësimit të riskut për te gjitha pozitat e punës e përpiluar nga kompania Trend CM-SH" (e licencuar për SSHP), mirëpo ky raport nuk është dorëzuar i noterizuar siç është kërkuar në DT, është dorëzuar i noterizuar një vërtetim i lëshuar nga "Trend CMSH" i cili nuk është kërkuar në DT, pra kërkesa ka qenë që raporti i vlerësimit te riskut të jetë i noterizuar dhe OE nuk ju ka përmbajjt kësaj kërkesë te FDT-së, prandaj edhe ky pretendim i juaji nuk qëndron.

Pretendimi juaj lidhur me Shpresa Haziri, është i bazuar, po kjo nuk ndryshon vendimin e Autoritetit kontraktues, sepse ju nuk plotësoni kërkesat e lartpërmendura në FDT-ë”.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.06.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0534/2024, ndërsa me datë 18.07.2024 është dorëzuar

raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0534 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit. ndërsa OE pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.SH.T. “VIKTORY COM” - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0534 kanë vlerësuar si në vijim:

Pretendimi 1. Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar për arsyeje se lista e punëtorëve është ne emër te një projekti tjetër. Ne ju sqarojmë se lista është njëjtë për te gjitha projektet dhe nuk ndryshohet sepse i kemi punëtoret e njëjtë gjithashtu si dëshmi plotësuese i kemi te bashkangjitur edhe Listën e ATK-se ku kjo liste është dëshmi se ne kemi këta punëtorë dhe se ne plotësojmë kushtin dhe kriterin e kontratës pra ne dosjen e tenderit nuk është kërkuar te paraqitet lista e punëtorëve me emër te projektit dhe si dëshmi po ju dërgojmë edhe njëherë. **Dëshmi gjeni Listën e Pagave ne ATK ku nr. i Punëtorëve është 165.**

Pretendimi 1 ankimor nga ana e kompanisë është pretendim i bazuar:

Arsyeja: Asnjë nga kriteret e paraqitura nga Autoriteti Kontraktues nuk ka thekson se lista e pagave e punëtorëve duhet të jete për Projektin në fjalë apo për ndonjë projekt tjetër dhe se AK nuk mund të eliminoi asnjë operator për një kërkesë të cilën se ka të paraqitur në FDT. Kështu duke e ditur që OE ka bashkangjitur listën zyrtare të nxjerre nga ATK i bije se punëtorët janë punëtor të kompanisë në fjalë.

Pretendimi 2. Se udhëheqësit të punishtës i mungon certifikata për menaxhimin e kantierit ju sqarojmë se për shkak të volumit të dokumenteve nuk është ngarkuar i gjithë fili për shkak të megabytve të file-it dhe si dëshmi po ju përcëllimin Certifikatën për Menaxhimin e Kantierit.

Pretendimi 2 ankimor nga ana e kompanisë është pretendim i bazuar:

Arsyeja: Kjo certifikate është dashur të kërkohet nga ana e Autoritetit Kontraktues, pasi që ekziston mundësia për verifikim nëse i njëjti z. Zogu e ka pas certifikatën para datës së aplikimit.

Pretendimi 3. Autoriteti Kontraktues nuk mund të na eliminojë për arsye jo eliminuese, ku si dëshmi e inxhinierit të elektro është kontrata e tij e dorëzuar në dosjen e tenderit. Në bazë të nenit 72, AK duhet të kërkojë sqarime shtesë për dokumentet dhe dëshmitë që gjenden në ofertë, për të plotësuar dokumentet dhe për ti sqaruar ato. Si dëshmi, po ju dërgojmë kontratën e inxhinierit dhe CV-në.

Pretendimi 3 ankimor nga ana e kompanisë është pretendim i bazuar:

Arsyeja: Për të gjitha detajet që AK i ka paraqitur për z. Kristë Duzhani janë detaje të cilat gjene zbatim në nenin 10 të Udhëzuesit 001/2023 dhe se të njëjtat është dashur të kërkohen përmes nenit 72 të LPP-së.

Pretendimi 4. Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar me arsyen se Punëtorët e Certifikuar si pas SSHP-se nuk kanë liste, ky pretendim i AK është i pabazuar. Pasi që në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të ketë të certifikuar 50 punëtorë me certifikatat e Siguria dhe Shëndeti në Pune (SSHP-se) ku si dëshmi janë certifikatat e punëtorëve dhe dëshmia tjetër është lista punëtorëve dhe lista e Pagave të ATK-se. Gjithashtu edhe punëtorët e Kompanisë Nsht Viktory Com të cilët gjenden në Dosjen e Tenderit janë të certifikuar Siguria dhe shëndeti në Pune dhe si dëshmi do të ju paraqesim.

Pretendimi 4 ankimor nga ana e kompanisë është pretendim i bazuar:

Arsyeja: Ky kriter nuk ishte kriter i FDT-se (ku theksohet se duhet qe lista e punëtorëve dhe certifikatat duhet te jene ne emër te projektit ne fjale), si i tille arsyeja e eliminimit është e pabazuar.

Pretendimi 5. Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar me arsyen se nuk kemi vlerësimin e rrezikut. Ky pretendim është i pabazuar për arsyen se asnjë punëtor nuk mund të certifikohet për siguri dhe shëndet në punë pa e pasur vlerësimin e rrezikut, dhe vlerësimi i rrezikut gjendet në ofertën tonë. Gjithashtu, e kemi të noterizuar edhe vërtetimin për të cilin dëshmohet se Kompania Eskavatori ka vlerësim të rrezikut dhe është i noterizuar. Ky kriter është i plotësuar nga grupi ynë.

Pretendimi 5 ankimor nga ana e kompanisë është pretendim i bazuar:

Arsyeja: Shiko kriterin se çfarë theksohet: Operatori Ekonomik duhet te ketë vlerësimin e rrishtit për te gjitha pozitat e punës nga një kompani e licencuar MPMS dhe te dëshmohet me raport te noterizuar. Dëshmia e kërkuar: Vërtetim nga një kompani e licencuar nga MPMS (kopje). Kompania ne fjale ka paraqitur vërtetimin e paraqitur nga kompania e licencuar ku thekson se e ka kryer vlerësimin e riskut. Raporti i vlerësimit te riskut është raport 70-80+ faqe dhe se i njëjti është vërtetuar (noterizuar) përmes vërtetimit te noterizuar.

Pretendimi 6. Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar me arsyen se Shpresa Haziri, e cila është Lead Auditor sipas ISO 9001-2015, nuk plotëson kriteret. Ky pretendim është i pabazuar për arsyen se Shpresa Haziri në të kaluarën e ka pasur mbiemrin Veseli dhe gjendet në listën e pagave të ATK-së dhe në listën e punëtorëve. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues është i obliguar, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), të kërkojë sqarime shitesë për dokumentet dhe dëshmitë të cilat gjenden në ofertë, dhe ne si Operator Ekonomik jemi të detyruar ti përgjigjemi kërkesës suaj. Andaj, po ju dërgojmë dëshmitë se punëtorja Shpresa Haziri ka pasur mbiemrin Veseli. Si dëshmi, gjeni aktvendimin e lëshuar nga Komuna e Ferizajt.

Pretendimi 6 ankimor nga ana e kompanisë është pretendim i bazuar:

Arsyeja: Autoriteti Kontraktues duhet te ketë kujdes lidhur me vendosjen e kriterëve dhe vlerësimin e tyre. OE ka paraqitur ne detaje kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën dhe se e njëjta është trajtuar si e mangët nga AK. Pretendimi është pretendim i bazuar dhe se kriteri i paraqitur nuk ishte kriter qe përcakton se ku duhet te jete i punësuar Lead Auditori me ISO 9001-2015.

Pretendimi i fundit:

Autoriteti nuk ka kërkuar listën e pajisjeve dhe te stafit pasi që këto ishin për një projekt tjetër. Si Ekspert profesional theksoi se AK ka bere shkelje te LPP-se, Udhëzuesit dhe Rregullores pasi që është dashur te shteren te gjitha mundësitë për trajtimin e barabartë te Operatoreve Ekonomik duke i kërkuar sqarime përmes nenit 72 të LPP-së dhe te mos vlerësoi dhe eliminoi OE për kriteret te cilat nuk i ka kërkuar fare.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtrësar e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë dhe ja fal besimin Raportit të tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i Rrugës X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.SH.T. “VIKTORY COM” dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.SH.T. “VIKTORY COM” janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i Rrugës X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1, të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe shqyrtimit të kësaj lënde me disa vendime nga OSHP me nr. 2023/0560, 2023/0572, 2024/0090, 2024/0100, është konstatuar edhe nga ekspertët shqyrtues dhe teknik se AK me rastin e vlerësimeve dhe ri-vlerësime ka bërë shkelje të dispozitave ligjore për prokurim publik lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i Rrugës X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1. Andaj, obligohet AK të kthehet në rivlerësim prap këtë aktivitet të prokurimit si dhetë veproj në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Gjakovës. që në tërësi të zbatohen vendimet e OSHP. OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës, që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna Gjakovë në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - N.SH.T. VIKTORY COM**
- Arkivës së OSHP-së: